



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 14.09.2026

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbimi i hartimit të studimeve gjeologjike, sizmologjike, efencës dhe VNM-ve”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Studime inxhinierike 71335000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT:

*2,496,167 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë)
Lek pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Durrës për vitin 2026.*

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.287 e nr.9830 prot., datë 14.07.2026, ndryshuar me urdhrin nr. 368, datë 25.08.2026, nr. 9830/1 prot., të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike si dhe Përllogaritjen e Fondit Limit, për procedurën e prokurimit me objekt: *“Shërbimi i hartimit të studimeve gjeologjike, sizmologjike, efencës dhe VNM-ve”*, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve për vitin 2026-2028.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit nëpërmjet dokumenteve:

- Sipas miratimit të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028.
- Shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga: Grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

I. PËRLLOGARITJA E VLERES LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt: “*Shërbimi i hartimit të studimeve gjeologjike, sizmologjike, efencës dhe VNM-ve*”, grupi i punës u bazua në çmimin mesatar të ofertave të marra nga studio projektimi që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë.

Mbështetur në rezultatin e sipër nxjerrë, rezultoi i se: Vlera e përgjithshme e kontratës sipas preventivit bashkëngjitur të jetë: 2,496,167 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë: brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve, nga nënshkrimi i kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;
- b. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”, si dhe në përputhje me Dokumentet e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr.08, datë 23.09.2024.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të shtojcës 9. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 2 (dy) vitet e fundit financiare 2024, 2025, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se 40% e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 2, germa c) e 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara për vitin 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Referuar rekomandimit të APP-së nr.3261/5 prot., datë 27.11.2025 ”Mbi problematikat e konstatuara gjatë verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik”, pika 3 e tij ”Për hartimin e kërkesave të veçanta”, Fq 4.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, në nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025, përfshirë këstet e maturuara të vitit 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërish i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet

pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

Për sa i përket kapaciteteve teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat janë hartuar dhe vendosur nga struktura e posaçme e specializuar, sipas urdhrit nr.287 e nr.9830 prot., datë 14.07.2026, ndryshuar me urdhrin nr. 368, datë 25.08.2026, nr. 9830/1 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor e si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit.

Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shenim: Duke qenë se kemi të bëjmë me prokurim të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar me cilësi kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin

dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë profesionale për Projektim, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:

9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a-** Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
- b-** Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.
- d-** Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/persona juridikë).

- a-** Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.
- b-** Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.
- c-** Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.
- e-** Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. Ofertuesit duhet të sjellin Licencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licencat e mësipërme janë vendosur ne kuadër te natyrës se përgjithshme te punimeve qe priten te realizohen ne këtë procedure.

Për arsye të vështirësisë së objekteve të kontratës, rehabilitimi i rezervuarëve në Bashkinë e Durrësit, rëndësisë strategjike të tyre në pikëpamjen bujqësore po dhe si pika atraksioni, si dhe problematikat e shfaqura në vite që lidhen me ndërtimin e zonave të banuara poshtë zonave të sigurisë së digave, zona me infrastrukturë ekzistuese mbi dhe nëntokësore, si dhe kërkesave për garancinë e funksionimit dhe cilësisë së tyre sipas standardeve bashkëkohore, të pajisura me elemente inovative të efikasitetit dhe energjisë, vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
9 – a	Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.	Bazuar në termat e referencës, projektimi i godinave të banimit deri 5 kate, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
9 – b	Studim/gjeologo-inxhinierik I truallit për objektet civile- ekonomike mbi 5 kate.	Bazuar në termat e referencës, projektimi i godinave të banimit mbi 5 kate, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
9 – d	Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët	Bazuar ne termat e referencës parashikohet te behet një vlerësim dhe ndërhyrjet përkatëse ne bazamentin e objekteve dhe trojeve qe e kufizojnë atë. Duke marre ne konsiderate këtë fakt vlerësimi gjeologjik për këtë kategori është i justifikuar pasi do kemi te bëjmë me sigurimin e qëndrueshmërisë se trojeve.
12-a	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.	Bazuar në termat e referencës, kërkohet domosdoshmërisht vlerësimi dhe studimi sizmik për vlerësimin e kapaciteteve për të përcaktuar skemën e ndërhyrjes dhe shkallën e dëmeve, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
12-b	Studim/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore	Bazuar ne termat e referencës parashikohet te behet një vlerësim dhe ndërhyrjet përkatëse ne bazamentin e objektit dhe trojeve qe e kufizojnë atë. Duke marre ne konsiderate këtë fakt vlerësimi sizmik për këtë kategori është i justifikuar pasi do kemi te bëjmë me sigurimin e qëndrueshmërisë se trojeve dhe te vete objekti.
12-c	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës	Bazuar ne termat e referencës parashikohet te behet një vlerësim dhe ndërhyrjet përkatëse ne bazamentin e objekteve të infrastrukturës rrugore dhe trojeve qe e kufizojnë atë. Duke marre ne konsiderate këtë fakt

	rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.	vlerësimi sizmik për këtë kategori është i justifikuar pasi do kemi të bëjmë me sigurimin e qëndrueshmërisë së trojeve dhe të vetë objekti
12-e	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi	Bazuar në termat e referencës parashikohet të bëhet një vlerësim dhe ndërhyrjet përkatëse në trojet e shpate me qëndrueshmëri të ulët që e kufizojnë atë. Duke marrë në konsideratë këtë fakt vlerësimi sizmik për këtë kategori është i justifikuar pasi do kemi të bëjmë me sigurimin e qëndrueshmërisë së trojeve dhe të vetë objekti

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë staf kryesor si drejtues teknik si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik/Gjeologji,
- b. 1 (një) Inxhinier Gjeofizik /Sizmiolog,
- c. 1 (një) Inxhinier Mjedisi.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për stafin kryesor operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë;
- Kontratë pune (e vlefshme) dhe CV;
- Të figurojnë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik.
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën 3 **muajt e fundit**. Për këtë duhet të dorëzohen listpagesat sipas formatit E-Sig 025/a.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licencuar për shërbimet që priten të realizohen.

- Punimet për studimin dhe vlerësimin gjeologjik do të jene te pranishme kryesisht ne vlerësimin gjeologjik dhe gjeoteknike për vlerësimin bazamentit, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te paktën **1 një inxhinieri Gjeolog/Gjeoteknik**, si staf kryesor.
- Punimet për studimin dhe vlerësimin sizmologjik do të jene te pranishme kryesisht ne vlerësimin sizmologjik për vlerësimin bazamentit, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te paktën **1 një Inxhinier Gjeofizik /Sizmiolog**, si staf kryesor.
- Punimet për shërbimin e projektimit te studimeve mjedisore parashikohen bazuar ne termat e referencës, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te paktën **1 (një) inxhinieri Mjedis**, si pjese e stafit kryesor.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Topograf
- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- 1(një) auditues Energjitik i certifikuar i pajisur me Certifikatë Audituesi Energjitik të lëshuar nga Agjencia për eficiensen e Energjisë dhe I regjistruar në Regjistrin e Audituesve Energjitikë të Certifikuar

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për stafin mbështetës operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë;
- Kontratë pune (e vlefshme për gjithë periudhën e angazhimit për këtë objekt);
- Licence projektimi/ certifikatë.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Meqenëse kemi të bëjmë me rikonstrukcion të një objekti kompleks siç janë digat dhe rezervuarët përkatës prezencë e stafit të mësipërm është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht;

Inxhinieri i Ndërtimit siguron analizimin e kushteve të terrenit nga pikëpamja gjeoteknike, vlerësimin e ndikimit të tyre në tipologjinë dhe zgjidhjet konstruktive të veprave, si dhe koordinimin ndërdisiplinor të të gjitha studimeve që shërbejnë si bazë për hartimin e projekteve të zbatimit për këtë arsye **inxhinieri i ndërtimit** duhet të jetë pjesë e stafit mbështetës

Kërkesa për disponimin e **një Inxhinieri Mjedis** është e domosdoshme për realizimin e objektit të kontratës, pasi një nga komponentët kryesorë të shërbimit është hartimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe analiza e ndikimeve mjedisore që lidhen me investimin. Ky specialist është përgjegjës për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme në komponentët e mjedisit, propozimin e masave parandaluese dhe zbutëse, si dhe hartimin e planit të monitorimit mjedisor në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e studimeve dhe projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të punimeve topografike si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezencë e të paktën **1 (një) gjeodet/markshajder/topograf** si pjesë e stafit ndihmës.

1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, gjykohet si i domosdoshëm si pjesë e stafit ndihmës për realizimin dhe aplikimin në sistem të VNM (Vlerësimet e ndikimit në Mjedis) për projektet që do të realizohen.

Kërkesa për disponimin e **1 (një) Audituesi Energjitik** të certifikuar, të pajisur me Certifikatë Audituesi Energjitik të lëshuar nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë dhe të regjistruar në Regjistrin e Audituesve Energjitikë të Certifikuar, është e domosdoshme për hartimin e dokumentacionit për Certifikatën Paraprake të Performancës së Energjisë duhet të bazohet në kërkesat e legjislacionit në fuqi për performancën energjetike të ndërtesave dhe në kërkesat teknike të përcaktuara për ndërtesat e reja.

Për fazën e projektimit dhe aplikimit për leje ndërtimi, konsulenti do të përgatisë dhe dorëzojë dokumentacionin teknik të nevojshëm për pajisjen e objektit me **Certifikatën Paraprake të Performancës së Energjisë (CPE)**.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën **8 (tetë)** punonjës sipas periudhës së kërkuar të deklaruar, të vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e kërkuar të deklaruar.

b) Listpagesat e punonjësve te konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit qe kërkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën e kërkuar të deklaruar.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale te kërkuar argumentojmë se jemi bazuar ne shërbimet e kërkuara sipas Termave te Referencës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mësipërm përkon me stafin qe pritet te jete i angazhuar ne këto procedura.*

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira:

- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station/GPS.
- 1(një) Pajisje sond për shpim e montuar mbi zinxhirë për shpime gjeologjike.
- 1(një) pajisje sizmike për kategorizimin e tipit te truallit për kryerjen e matjeve tip MASW HVSR, Refraction dhe DST.

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qira të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat të përshtatshme ose ekuivalentet e tyre për objektin e prokurimit si mëposhtë:

- a) ISO 9001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë;
- b) ISO 14001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë së mjedisit;

Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Certifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe të ketë të specifikuar objektin e kontratës së prokuruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Certifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

2.4.2 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një CV të shoqërisë dhe stafit të propozuar, ku të përfshihen kontrata të ngjashme, Referenca/Vërtetime, Certifikata ISO, Organigrami, Metodologji, Trajnime, Kualifikime, për qëllime të vlerësimit.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 2/b dhe 5 të nenit të 87, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 45, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, 2. Oferta ekonomike më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë: organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës;

Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomike më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Kontrata synon hartimin e studimeve gjeologjike-inxhinierike, sizmologjike dhe të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), të domosdoshme për plotësimin e dokumentacionit teknik të projekteve që Bashkia Durrës do t'i dorëzojë për oponencë teknike. Këto studime janë parakusht ligjor për vazhdimin e procedurave të projektimit dhe zbatimit të veprave publike (ndërtim/rikonstrukcion objekteve, infrastrukturë rrugore, mbrojtje nga rrëshqitjet, rehabilitim zonash).

Kërkesat teknike bazohen drejtpërdrejt në kuadrin rregullator në fuqi: VKM Nr. 9, datë 11.1.2024 – përcakton se cilat projekte i nënshtrohen oponencës teknike dhe procedurën përkatëse (ky është shkaku kryesor pse kërkohen studimet gjeologjike/sizmologjike/mjedisore); Ligji Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"; Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" (i ndryshuar); VKM Nr. 1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponencës teknike"; Urdhri Nr. 197, datë 09.10.2014; VKM Nr. 354, datë 11.05.2016

(manuali i tarifave, përdoret për llogaritjen e çmimeve njësi/preventivit); VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 (procedura e VNM-së).

Kërkesa për investigim gjeoteknik sipas kategorive I dhe II të Eurocode-it argumentohet me nevojën për të vlerësuar qëndrueshmërinë e shpateve/skarpave dhe kushtet gjeologjike të terrenit (dherë, shkëmb, ujëra nëntokësorë) përpara se të vendosen zgjidhjet teknike përfundimtare.

Kërkohet raport VNM me dy përbërës (Raport paraprak + Relacion teknik) sipas VKM Nr. 686/2015, e cila detajon elementet e detyrueshme (mbulesa bimore, burime ujore, ndikime në biodiversitet, shkarkime, kohëzgjatje ndikimesh, alternativa, etj.) Certifikata Paraprake e Performancës Energjetike (CPE), lidhet me detyrimin ligjor për performancën energjetike të ndërtesave të reja gjatë fazës së aplikimit për leje ndërtimi, dhe kërkon nënshkrim nga Auditues Energjetik i Certifikuar. Kërkesa për licenca profesionale në kategoritë 9 (Studim gjeologjiko-inxhinierik/hidrogeologjik) dhe 12 (Studime të sizmologjisë inxhinierike) justifikohet nga natyra e shërbimit të kërkuar, pa këto licenca, operatori nuk mund të kryejë ligjërisht studimet objekt kontrate. Kërkesa për ekip ekspertësh minimal (me kualifikime specifike) synon garantimin e cilësisë dhe përfundimin efikas të detyrës brenda afatit. Afati prej 12 muajsh justifikohet me natyrën e vazhdueshme të nevojave të autoritetit .

Termat e referencës dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Termat e referencës, preventivi, grafiku, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit